

Vështrime leksikografike

Struktura gramatikore e fjalëve me vizëlidhëse në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe

Mr. Agim Spahiu

28.05.2008

Përmbledhje

Në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980 (më tutje **FGJSSH**) janë përfshirë 225 fjalë të formuara me vizëlidhëse. Ky numër është i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të cilin e përmban ky Fjalor (kur dihet se Fjalori përmban mbi 41000 fjalë e shprehje). Por, megjithatë, këto fjalë janë me interes për studiuesin e gjuhës shqipe për faktin se ato kanë një strukturë bukur të larmishme fjalëformuese dhe gramatikore. Prandaj kjo është edhe arsyeja që iu qasem kësaj kategorie leksiko-gramatikore.

Në FGJSH janë përfshirë gjithsej 225 fjalë e togje fjalësh të formuara me vizëlidhëse. Prej tyre 49 janë emra: 25 të gjinisë mashkullore dhe 24 të asaj femërore. Mbiemra ka më shumë: janë gjithsej 64, ndërsa ndajfolje edhe më shumë: 99. Të paktë janë përemrat të pacaktuar: vetëm 5 sish, trajta onomatopeike: 3, dhe vetëm 1 pjesëz.

Këtu më poshtë po i prezantojmë në formë tabelash kompozitat emërore (të gjinisë mashkullore e femërore), mbiemërore, ndajfoljore, përemërore (përemrat e pacaktuar, onomatopeike dhe pjesëzat, të formuara nga dy trajta (në ndonjë rast të rrallë edhe me tri) me vizëlidhëse.

Emrat mashkulorë dhe femërorë	
ASFALT-BETON m. ndërt.	BAR-BUFE f.
DIVAN-KREVAT m.	BAR-KAFE f.
DYQAN-SHTËPI m.	BAR-LULISHTE f.
GJUAJTËS-BOMBARDUES m.	BESA-BESË f.
HEKUR-NIKEL m. min.	CINGRA-MINGRA f. vet
HOTEL-RESTORANT m.	ÇIKLA-MIKLA f. vet. bised.
KALË-FUQI m. fiz., tek.	DITË-NJERI f.

KU-KLUKS-KLAN m.	DITË-PUNË f.
MONARKO-FASHIST m.	DHOMË-MUZE f.
NACIONAL-SOCIALIZËM m.	GRUP-ARMATË f. usht.
NGARKIM-SHKARKIM m.	GRUP-MOSHË f.
ORË-NJERË m. ek.	GRUP-ORGANIZATË f.
PESHK-KAVALL m. zool.	HYRJE-DALJE f. kryes.
PESHK-SHARRË m. zool.	KILOVAT-ORË f. elektr.
PESHK-SHIRIT m. zool.	ORË-NORMË f. ek.
PESHK-SHIGJETË m. zool.	PLAN-DETYRË f.
PESHK-SHPATË m. zool.	PRITJE-PËRCJELLJE f. kryes.
POSTË-TELEGRAF m.	PYETJE-PËRGJIGJE f. vet.
QEN-UJK m.	SËPATË-DALTË f.
QYTET-MUZE m.	SHTËPI-MUZE f.
QYTET-HERO m.	VAJTJE-ARDHJE f.
VINÇ-URË f. tek.	VINÇ-KULLË f. tek.
QYTET-SHTET m. hist.	XHINGLA-MINGLA f. vet.
SHPIM-SHFRYTËZIM m. min.	VIT-DRITË m. astr.
SHPIM-KËRKIM m. min.	

Tabela 1: Tabela me emrat mashkullorë dhe femërorë me vizëlidhëse.

Mbiemrat me vizëlidhëse	
ADMINISTRATIVO-TOKËSOR . drejt.	AFRO-AZIATIK
AGRARO-INDUSTRIAL	ANGLO-AMERIKAN
BRIGJE-BRIGJE	BUJQËSOR-INDUSTRIAL
CANGLA-CANGLA krahin.	CIRKA-CIRKA
ÇIFLIGARO-BORGJEZ	DREDHA-DREDHA
EKONOMIKO-SHOQËROR	EPIKO-LIRIK let.
FEUDO-BORGJEZ	FEUDALO-BORGJEZ
FIZIKO-USHTARAK	FLETË-FLETË
FSHIKA-FSHIKA	FULLTAKA-FULLTAKA
GËRXHE-GËRXHE	GRATHË-GRATHË
GROPA-GROPA	GUNGA-GUNGA
HUMBA-HUMBA	KËRKIMOR-SHKENCOR
KRELA-KRELA	KUTI-KUTI
LARA-LARA	LECKA-LECKA
LEKSIKO-GRAMATIKOR gjuh.	LEQE-LEQE
LESKRA-LESKRA	LULE-LULE
MAJA-MAJA	MONARKO-FASHIST
MORALO-POLITIK	NACIONAL-SOCIALIST
NGJYRA-NGJYRA	NJOLLA-NJOLLA

POLITIKO-IDEOLOGJIK	POLITIKO-EKONOMIK
POLITIKO-USHTARAK	POLITIKO-SHOQËROR
PULLA-PULLA	QUKA-QUKA
RRECKA-RRECKA	RREMBBA-RREMBBA
RRIPA-RRIPA II	RRUDHA-RRUDHA
SHKENCOR-POPULLOR	SHOQËROR-KULTUROR
SHPOFKA-SHPOFKA krahin.	SHTRESA-SHTRESA
TEKNIKO-SHKENCOR	TEKNIKO-TAKTIK
THEKË-THEKË	THELA-THELA
THEPA-THEPA	UJËRA-UJËRA
VIDRA-VIDRA	VIJA-VIJA
XIXA-XIXA	XHUNGA-XHUNGA
ZHELE-ZHELE	ZHUBRA-ZHUBRA

Tabela 2: Mbiemrat e formuar me vizëlidhëse në FGJSSH

Ndajfoljet me vizëlidhëse	
ANDEJ-KËTEJ	ARA-MARA
ARNA-ARNA	ARTHI-GOMARTHI krahin.
ASHKLA-ASHKLA	ASHTU-KËSHTU
ASHTU-ASHTU	ATY-ATY bised.
ATY-KËTU	AVASH-AVASH bised.
BISHTRA-BISHTRA	CEFLA-CEFLA
COPA-COPA	COPEË-COPEË
CUKA-CUKA	ÇALË-ÇALË
ÇIKA-ÇIKA	DALË-DALË
DALLGË-DALLGË	DARKA-DARKËS
DIKU-DIKU	DITA-DITËS
DORA-DORË	DORA-DORËN
DORA-DORËS	DUAR-DUAR
FIJE-FIJE	FJOLLA-FJOLLA
FLOKË-FLOKË	FUNDJA-FUNDJES
GOJA-GOJËS	GRIMCA-GRIMCA
GRUMBUJ-GRUMBUJ	GRUPE-GRUPE
GRYKA-GRYKAZI	GRYKA-GRYKAS
GULFA-GULFA	GJITHË-GJITHË bised.
GJOLLE-GJOLLE	HOLLË-HOLLË
HOPE-HOPE	HOVE-HOVE
HURBA-HURBA	KËMBA-KËMBËS
KËMBË-KËMBË	KOKRRA-KOKRRA
KORTARË-KORTARË (edhe fig.)	KURMA-KURMA

LEHE-LEHE	LEHTË-LEHTË
LITARË-LITARË	LUGË-LUGË
MENDJE-MENDJE	MIZA-MIZA
NATA-NATËS	PALA-PALA
PALË-PALË	PIKA-PIKA
PETË-PETË	PJESË-PJESË
PIKË-PIKË	PLLANGA-PLLANGA
PLIMA-PLIMA krahin.	PUFKA-PUFKA bised.
POSHTË-LART	RADHË-RADHË
QETË-QETË	ROGA-ROGA
RËNDË-RËNDË	RRATHË-RRATHË
RRAM-BAM bised.	RRËMBAJ-KËMBAJ
RREZGA-BJEZGA	RRISKA-RRISKA
RRICA-RRICA	SHAT-PAT bised.
SHATRA-PATRA bised.	SHKULE-SHKULE
SHKALLË-SHKALLË	SHTREMBA-SHTREMBA
SHTËLLUNGA-SHTËLLUNGA	TALLAZE-TALLAZE
SHUMË-SHUMË	TEPËR-TEPËR
TEK-TUK	TRAPA-TRAPA
TOGJE-TOGJE	UNAZA-UNAZA
TUFA-TUFA	VONË-VONË
VENDE-VENDE	VRUNDUJ-VRUNDUJ
VRIMA-VRIMA	XHUFKA-XHUFKA
VULA-VULA	YRRJA-BYRRJA bised.

Tabela 3: Ndajfoljet me vizëlidhëse në FGJSSH

Përemrat e pacaktuar, onomatopetë dhe pjesëzat	
LLOJ-LLOJ pakuf.	NJËRI-TJETRI pakuf.
SHOKU-SHOKU pakuf. bised.	SHOQJA-SHOQES pakuf. bised.
SHOQI-SHOQIT pakuf. bised.	TIK-TAK onomat.
DËR-DËR onomat. bised. keq.	PLLAQ-PLLUQ onomat. bised.
GATI- GATI pj.	

Tabela 4: Përemrat e pacaktuar, onomatopetë dhe pjesëzat në FGJSSH

Sa i përket anës fjalëformuese, marrë në përgjithësi, fjalët e formuara me vizëlidhëse janë një tip i veçantë i fjalëve të përbëra ose kompozita. Të këtilla i kanë konsideruar, në përgjithësi, edhe autorët e tekstit universitar të ASHSH-së **Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia, Vëllimi I**. Por te ndajfoljet mund të vëmë re se ka paqendrueshmëri:

herë i quajnë lokucione ndajfoljore, herë fjalë të përbëra¹.

Këto janë kompozita ngase përbëhen prej dy ose më shumë gjymtyrësh, me strukturë zakonisht: EMËR + EMËR (numri më i madhi tyre); MBIEMËR + MBIEMËR; NDAJFOLJE + NDAJFOLJE; PËREMËR I PACAKUAR + PËREMËR I PACAKTUAR; FJALË ONOMATOPEIKE + FJALË ONOMATOPEIKE dhe PJSËZ + PJSËZ.

Në këtë lloj kompozite mbizotërojnë lidhjet e bashkërenditjes këpujore dhe të nënrenditjes përcaktore a ndajshtimore.

Cilat konsiderohen kompozita me lidhje këpujore?

Në FGJSSH të vitit 1980 gjejmë disa kompozita fjalësh me vizëlidhëse të cilat shquhen me raporte të barabarësisë. Kjo do të thotë se asnjëra fjalë nuk mbizotëron tjetrën. Prandaj janë të një niveli, ngase gramatikisht mund të lidhen me lidhëzën këpujore shtuese **-e**, që në këtë tip nuk është e pranishme, por nënkuptohet(si p. sh.: *pritje e përcjellje, hyrje e dalje, ngarkim e zhgarkim, vajtje e ardhje; kërkimor e shkencor, bujqësor e industrial, (punë) teknike e shkencore; andej e këndeje, tutje e tehu, aty e këtu, tik e tak* etj.).Pra në Fjalor gjejmë: *hyrje-dalje; ngarkim-shkarkim, pritje-përcjellje, vajtje-ardhje, hotel-restorant, barë-lulishte, postë-telegraf* etj. dhe sidomos i atyre mbiemërore të tipit: *agro-industrial, bujqësor-industrial, ekonomiko-shoqëror, kërkimor-shkencor, leksiko-gramatikor, politiko-shoqëror, tekniko-shkencor, austro-hungarez, afro-aziatik; aty-këtu, andej-këndeje, tutje-tehu; tik-tak* etj.², siç i kemi vërejtur në tabelat e mësipërme.

Cilat me lidhje përcaktore?

Në këtë grup hyjnë të gjitha ato fjalë të bashkuara me vizëlidhëse në të cilat njëra gjymtyrë e përcakton tjetrën; ose e para të dytën. Por disa herë këtë funksion e luan gjymtyra e parë. Në kompozitat: *vinç-urë, kalë-fuqi, vit-dritë, vagonë-cisternë, vagon-restorant, qytet-hero, organizatë-bazë* etj., që shërbejnë si emërtime dhe kanë lidhje përcaktore-ndajshtimore ndërmjet pjesëve të tyre, gjatë lakimit të fjalës ose në formimin e shumësit ndryshon vetëm gjymtyra e parë³, pra kemi: *kuaj-fuqi, vagonët-cistern, qytetet-hero, organizatat-bazë* etj.

Përsëritja e fjalëve të njëjta ose të ndryshme, siç mund të vëmë re nga tabela e sipërpërmendura, është karakteristika më kryesore e këtij tipi kompozitash.

¹Për ndërtime të tipit: *copa-copa, dallgë-dallgë, gropa-gropa, grupe-grupe, lara-lara* etj., në krye të herës trajtohen si lokucione ndajfoljore, por ata, menjëherë më poshtë thuhet se përsëritjet e këtij tipi, me shkrim si një fjalë me vizë lidhëse, kanë marr tipare fjalësh të përbëra, shih tekstin e përmendur më lart, f. 378

²Shih *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, botimi i tretë, 2002, f.71/72; 387

³Po aty, f. 72.